REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DIBËR**

**KRYETARI**

**PROJEKT VENDIM**

**Nr. 01 Datë .07.2025**

**"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË BASHKISË DIBËR 2026 - 2028"**

Bazuar në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 1/1.1 gërma "b", nenin 23 pika 12, neni 24 pika 1, nenin 54 gërma "k", neni 55 pikat 2 dhe 6 të, Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. Me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**PROPOZOJMË:**

1. Miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026 – 2028 në Bashkinë Dibër, bashkëngjitur këtij dokumenti.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore ,Sektori i Arsimit dhe Kulturës.

*Adresa: Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi, Albania, nr.tel 0355 218 21 66,* bashkiadiber@gmail.com

3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga institucioni i Prefektit.

Përgjegjëse e Sektorit të Arsimit dhe Kulturës

Valbona KALOÇI

Drejtori I Burimeve Njerëzore

Malbora LALA

Drejtore e Financës

p/ Çeljeta ZUNA

Drejtori Juridik

Ismet SARACI

Kryetari i Bashkisë

Rahim SPAHIU

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETAR I BASHKISË

Lorenc GJIBAKU

REPUBLIKA E SHQIPERISË - BASHKIA DIBËR

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi, Albania, nr.tel 0355 218 21 66, bashkiadiber@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA DIBËR**
KRYETARI

2884
Nr______Prot

Peshkopi, më 29.07.2025

**RELACION**
**PËR**
**PROJEKT VENDIM**

**Nr. Datë .07 . 2025**

## "PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË BASHKISË DIBËR 2026 - 2028 "

Të nderuar Këshilltarë !

Bazuar në nenin 8 pika 2. nenin 9 pika 1/1. i gërma "b", nenin 23 pika 12, neni 24 pika 1, nenin 54 gërma "k", neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore". i ndryshuar, Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, propozojmë të miratohet nga Këshilli Bashkiak, "Plani i arsimit parauniversitar" në Bashkinë Dibër.

Plani i Arsimit Parauniversitar i Bashkisë Dibër 2026 – 2028 është hartuar si pjesë e angazhimeve ligjore dhe institucionale të bashkisë për garantimin e ofrimit të shërimeve arsimore cilësore, të aksesueshme dhe të përputhshme me nevojat e komunitetit.

Plani është hartuar në zbatim të kuadrit ligjor dhe strategjik kombëtar dhe vendor, konkretisht:

- Ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Dibër;
- Plani Social i Bashkisë Dibër 2024–2026.

Bashkia Dibër është një realitet i ndërthurur urban-rural, me 15 njësi administrative, ku ofrimi i shërbimeve arsimore parauniversitare përballen me sfida të lidhura me infrastrukturen, burimet njerëzore dhe karakteristikat demografike. Me mbi 50775 banorë.

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi, Albania, nr.tel 0355 218 21 66, bashkiadiber@gmail.com

Vizioni i bashkisë tonë është: *"Bashkia Dibër synon të zhvillojë një sistem arsimor parauniversitar gjithëpërfshirës, cilësor dhe të aksesueshëm, që u garanton të gjithë fëmijëve dhe të rinjve mundësi të barabarta për të mësuar, për t'u rritur dhe për të ndërtuar të ardhmen e tyre në një mjedis të sigurt, modern dhe nxitës. Nëpërmjet investimeve të planifikuara në përmirësimin e infrastrukturës, rikonstruksionin e shkollave dhe kopshteve, si dhe pajisjen e tyre me mjete bashkëkohore didaktike e teknologjike, vizioni synon të krijojë institucione arsimore funksionale dhe të mirëmenaxhuara në çdo cep të territorit – nga qendra urbane deri në zonat më të thella rurale. Ky vizion udhëhiqet nga bindja se arsimi është themeli i zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të mirëqenies sociale dhe rritjes së mundësive për çdo qytetar të Bashkisë Dibër."*

Duke u mbështetur në rrjetin ekzistues të institucioneve arsimore, nga kopshtet deri në shkollat e mesme dhe duke adresuar sfidat aktuale të aksesit, infrastrukturës dhe përfshirjes gjinore, Bashkia Dibër ka për synim:

- **Përmirësimin e infrastrukturës arsimore**, veçanërisht në zonat rurale, për të garantuar kushte dinjitoze mësimi në çdo shkollë e kopsht;
- **Përmirësimin e përfshirjes në arsimin parashkollor**, duke mbështetur prindërit dhe rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e edukimit të hershëm;
- **Zvogëlimin e pabarazive gjinore dhe sociale** në ndjekjen e shkollës në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar;
- **Rritjen e cilësisë së mësimdhënies**, përmes investimit në zhvillimin profesional të mësuesve dhe përdorimin e metodologjive bashkëkohore;
- **Forcimin e partneriteteve me komunitetin dhe institucionet arsimore** për të mbështetur suksesin e çdo nxënësi.

**Qëllimi 1 (Q1) Sigurimi i një mjedisi arsimor të sigurt, funksional dhe gjithëpërfshirës**

Të garantohen kushte të qëndrueshme infrastrukturore dhe funksionale për të gjitha institucionet arsimore në territorin e Bashkisë Dibër, përmes mirëmbajtjes sistematike dhe investimeve të orientuara drejt standardeve bashkëkohore.

- **Objektivi 1.1** – Të sigurohet ofrimi i shërbimeve mbështetëse në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive, duke përfshirë pagesat e personelit mësues në arsimin parashkollor dhe personelit ndihmës në kopshte dhe shkolla, mirëmbajtjen e ambienteve shkollore, përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare, funksionimin e sistemeve të ngrohjes, furnizimin me kancelari, mjete didaktike, ushqim, dokumentacion dhe transport.
- **Objektivi 1.2** – Të investohet në përmirësimin e infrastrukturës arsimore, përmes ndërtimit ose rikonstruksionit të kopshteve dhe institucioneve arsimore, pajisjes me mobilie si dhe ngritjes së një sistemi elektronik për regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave të institucioneve arsimore.

**Qëllimi 2 (Q2) Mbështetje për zhvillimin e plotë të fëmijëve përmes edukimit cilësor dhe përkujdesjes së integruar**

Të sigurohet zhvillimi emocional, social dhe kognitiv i çdo fëmije përmes shërbimeve edukative gjithëpërfshirëse dhe mbështetjes psiko-sociale në mjedise të sigurta dhe përkujdesëse.

- **Objektivi 2.1** – Të përmirësohet cilësia e edukimit në institucionet parashkollore përmes mbështetjes së kopshteve me mjete dhe organizimit të trajnimeve për edukatorët dhe ngritjes së kapaciteteve të stafit për të ofruar një edukim të hershëm gjithëpërfshirës dhe bashkëkohor.
- **Objektivi 2.2** – Të forcohet përkujdesja sociale për fëmijët përmes angazhimit të mësuesve ndihmës, ofrimit të shërbimeve psiko-sociale, krijimit dhe fuqizimit të strukturave menaxhuese pjesëmarrëse (këshillat e prindërve dhe bordet e shkollës), si dhe mbështetjes së nxënësve nga familjet në nevojë apo me rezultate të larta.

**Qëllimi 3 (Q3) Zhvillimi i talenteve dhe ndjesisë së përkatësisë përmes veprimtarive jashtëmësimore**

Të promovohet zhvillimi i potencialit krijues, fizik dhe social të fëmijëve përmes një kalendari të pasur aktivitetesh jashtëmësimore që nxisin shëndetin, bashkëpunimin dhe përfshirjen komunitare.

- **Objektivi 3.1** – Të organizohen rregullisht veprimtari kulturore, sportive dhe ndërgjegjësuese, si: ngjarje artistike, ekspozita, ditë ndërkombëtare tematike, aktivitete mjedisore dhe lokale, për të nxitur zhvillimin e aftësive dhe pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në jetën shoqërore.

Financimi i planit do të mbështetet në burime të kombinuara nga buxheti vendor, transfertat specifike dhe të pakushtëzuara nga qeveria qendrore, si dhe nga bashkëpunimi me partnerë zhvillimi dhe donatorë.

Plani përmban gjithashtu mekanizma të qartë të monitorimit, indikatorë matës të progresit dhe ndikimit, raportim vjetor, rishikim afatmesëm dhe pjesëmarrje të aktorëve lokalë dhe komunitetit në vlerësim.

Duke vlerësuar përmbajtjen e planit, qasjen strategjike dhe qartësinë e objektivave të tij, si dhe duke pasur parasysh domosdoshmërën për të përballuar sfidat aktuale të arsimit në territorin e Bashkisë Dibër, mbështetur në nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 1/1.1 gërma "b", nenin 23 pika 12, neni 24 pika 1, nenin 54 gërma "k", neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar,. paraqesim për shqyrtim dhe miratim projekt vendimin **Planit të Arsimit**

Parauniversitar 2026–2028, si dokumenti udhëheqës i veprimtarisë arsimore dhe planifikimit buxhetor të lidhur me sektorin e arsimit parauniversitar.

Konceptoi:
A . Lleshi: S. Vlesha
Pranoi:
V. Kaloçi
Miratoi:
M. Lala

**KRYETARI I BASHKISË**

**Rahim Spahiu**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/ KRYETARI I BASHKISË

Lorenc Cibaku

BASHKIA DIBËR



# Plani Arsimit Parauniversitar 2026 - 2028

Përmbajtja


1. Hyrje dhe konteksti ........ 6
Konteksti administrativ ........ 6
Të dhëna demografike ........ 7
2. Kuadri ligjor dhe politikat që përcaktojnë bazën referuese për përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor – Bashkia Dibër ........ 8
3. Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025 ........ 9
Shpërndarja e dhe mbulimi i shërbimit të institucioneve arsimore në Bashkinë Dibër ........ 9
Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor ........ 10
Frekuentimi në kopshte ........ 10
Analizë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbështetjen e ofruar ........ 11
Fëmijë nga familje egjiptiane ........ 11
Fëmijë nga familje me ndihmë ekonomike ........ 12
4. Analiza e shërbimit të në shkolla bazë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024 – 2025 ........ 12
Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit (shkollat) ........ 12
Frekuentimi në arsimin fillor ........ 13
Frekuentimi arsimi 9-vjecar ........ 13
Frekuentimi arsimi i mesëm ........ 13
5. Analiza edhe shperndarja e stafit arsimor në territorin e bashkisë ........ 14
Shkolla ........ 14
Kopshte ........ 15
6. Shërbimi i Arsimit sipas njësive administrative ........ 15
Njësia Administrative: Peshkopi ........ 15
Njësia Administrative: Tomin ........ 16
Njësia Administrative: Melan ........ 17
Njësia Administrative: Kastriot ........ 18
Njësia Administrative: Maqellarë ........ 19
Njësia Administrative: Luzni ........ 20
Njësia Administrative: Selishtë ........ 20
Njësia Administrative: Sllovë ........ 20
Njësia Administrative: Kala e Dodës ........ 21
Njësia Administrative: Zall-Dardhë ........ 21
Njësia Administrative: Zall-Reç ........ 22
Njësia Administrative: Fushë Çidhën ........ 22
Njësia Administrative: Arras ........ 22
Njësia Administrative: Muhurr ........ 23

7. Vizioni, qëllimet strategjike, objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar ........ 24
Përmbledhje e Qëllimeve, Objektivave dhe Aktiviteteve ........ 25
Përmbledhje e investimeve kapitale (2026–2028) ........ 25
8. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar ........ 26
Të ardhurat vendore dhe transferimet nga qeveria qendrore për shërbimin e arsimit parauniversitar ........ 26
Buxheti që mbështetë Planin për Arsimin bazë përfshirë arsimin parashkollor ........ 27
Buxheti që mbështetë Planin për Arsimin e mesëm të përgjithshëm ........ 27
9. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve) ........ 28
10. Plani i investimeve kapitale ........ 42
11. Monitorimi dhe vlerësimi ........ 43
12. Rishikimi dhe përshtatja e planit ........ 44
13. Raportimi dhe transparenca ........ 45
14. Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar ........ 46

## Parathënie

Bashkia Dibër synon të zhvillojë një sistem arsimor parauniversitar gjithëpërfshirës, cilësor dhe të aksesueshëm, që u garanton të gjithë fëmijëve dhe të rinjve mundësi të barabarta për të mësuar, për t'u rritur dhe për të ndërtuar të ardhmen e tyre në një mjedis të sigurt, modern dhe nxitës. Nëpërmjet investimeve të planifikuara në përmirësimin e infrastrukturës, rikonstruksionin e shkollave dhe kopshteve, si dhe pajisjen e tyre me mjete bashkëkohore didaktike e teknologjike, vizioni synon të krijojë institucione arsimore funksionale dhe të mirëmenaxhuara në çdo cep të territorit – nga qendra urbane deri në zonat më të thella rurale. Ky vizion udhëhiqet nga bindja se arsimi është themeli i zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të mirëqenies sociale dhe rritjes së mundësive për çdo qytetar të Bashkisë Dibër.

Përballë sfidave të shpërndarjes territoriale, nevojave për rikonstruksion dhe përmirësim të vazhdueshëm të kushteve arsimore, Bashkia Dibër ka ndërmarrë një qasje të strukturuar dhe afatmesme për përmirësimin e shërbimeve arsimore.

Ky plan strategjik 2025–2028 përfshin ndërhyrje të rëndësishme kapitale, përfshirë rikonstruksionin e disa shkollave dhe kopshteve, përmirësime të infrastrukturës, pajisjen me mjete, si dhe përforcimin e kapaciteteve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse.

Ky dokument është fryt i analizës së situatës aktuale në çdo njësi administrative të territorit, dhe një udhërrëfyes konkret për të adresuar boshllëqet ekzistuese, duke rritur aksesin, përfshirjen dhe cilësinë në arsim.

Në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Dibër, ritheksoj angazhimin tim të plotë institucional për zbatimin e këtij plani, në partneritet me institucionet arsimore, komunitetin lokal dhe aktorët e tjerë publikë e joqeveritarë.

Ne besojmë se çdo investim në arsim është një gur themeli për të ardhmen tonë të përbashkët.

**Kryetari i Bashkisë Dibër**

**Rrahim Spahiu**

## *Falënderime*

*Bashkia Dibër shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit të të Arsimit Parauniversitar 2026–2028. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të bashkive të Shqipërisë dhe me ekspertizën teknike të "Smart Processes", të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik vendor.*

*Falënderojmë në mënyrë të veçantë angazhimin e Këshillit Bashkiak të Dibrës, për mbështetjen e dhënë gjatë gjithë procesit, si dhe për angazhimin e strukturave të tij në sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe transparente.*

*Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive dhe sektorëve vendorë të arsimit, financave, infrastrukturës, shërbimeve sociale, si dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, edukatorëve dhe mësuesve që ofruan informacion të vlefshëm dhe reflektim mbi nevojat reale në terren.*

*Mirënjohje shkon edhe për organizatat e shoqërisë civile, këshillat e prindërve, grupet komunitare dhe partnerët lokalë, të cilët morën pjesë në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e realitetit arsimor dhe prioriteteve të komunitetit.*
*Ky plan përfaqëson një vullnet të përbashkët për të ndërtuar një sistem arsimor më të mirë për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Dibër.*

## 1. Hyrje dhe konteksti

### Konteksti administrativ

Bashkia Dibër shtrihet në verilindje të Shqipërisë, me një sipërfaqe prej **937.88 km²** dhe një popullsi të regjistruar prej 50.775 banorësh, sipas Census 2023. Qendra administrative e bashkisë është qyteti i Peshkopisë, ndërsa territori i saj përfshin gjithsej **15 njësi administrative** dhe **141 fshatra**, të shpërndara në një zonë me karakter kryesisht **kodrinor dhe malor**, ku nuk mungojnë edhe pjesë fushore përgjatë rrjedhës së **lumit Drin i Zi**, që ndihmon zhvillimin e bujqësisë dhe pemëtarisë.

Bashkia kufizohet me Kukësin në veri, Mirditën në veri-perëndim, Matin në perëndim, Klosin në jug-perëndim, Bulqizën në jug dhe Republikën e Maqedonisë në lindje. Ky pozicion gjeografik e bën Dibrën një nyje të rëndësishme për bashkëpunim ndërkufitar dhe zhvillim rajonal.

Me një densitet popullsie prej rreth 80 banorë/km², Dibra është një nga bashkitë më të mëdha në vend për nga territori dhe një ndër ato me shtrirjen më të gjerë rurale, çka sjell sfida të veçanta në qasjen ndaj shërbimeve publike, përfshirë arsimin, shëndetësinë dhe infrastrukturën rrugore.

Aktualisht, Bashkia Dibër përfshin gjithsej 15 njësi administrative:

- Peshkopi,
- Tomin,
- Melan,
- Kastriot,
- Lurë,
- Maqellarë,
- Muhurr,
- Luzni,
- Selishtë,
- Sllovë,
- Kala e Dodës,
- Zall-Dardhë,
- Zall-Reç,
- Fushë Çidhën,
- Arras

të cilat përbëjnë bazën e ofrimit të shërbimeve publike, përfshirë arsimin parauniversitar, kopshtet dhe shkollat publike.0

| *Të dhëna administrative* | **Vlerë** |
|---|---|
| *Sipërfaqja* | 937.88 km² |
| *Popullsi bashkisë* | 50,775 (Cens 2023) |
| *Popullsi Peshkopi* | 14,700 (Cens 2023) |
| *Njësi administrative* | Peshkopi, Tomin, Melan, Kastriot, Lurë, Maqellarë, Muhurr, Luzni, Selishtë, Sllovë, Kala e Dodës, Zall-Dardhë, Zall-Reç, Fushë Çidhën, Arras |
| *Fshatra të përfshira* | 141 fshatra përmes njësive |

Të dhëna demografike

Sipas të dhënave më të fundit demografike, numri total i banorëve në Bashkinë Dibër është 50,775 banorë, me një shpërndarje të përafërt gjinore prej 25,547 meshkuj dhe 25,228 femra. Struktura e popullsisë karakterizohet nga një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve në moshë parashkollore dhe të rinjve, gjë që nënvizon rëndësinë e zhvillimit dhe forcimit të shërbimeve arsimore në këto kategori.

Të dhënat demografike për Bashkinë Dibër tregojnë shpërndarjen e popullsisë sipas njësive administrative dhe gjinisë. Analiza e përgjithshme sjell në vëmendje sa vijon:

- Numri më i lartë i banorëve gjendet në Njësinë Administrative **Peshkopi**, me mbi 14,700 banorë, ndjekur nga **Kastrioti** me mbi 5,200 banorë.
- Në shumicën e njësive, raporti gjinor është pothuajse i balancuar, me një ndarje të përafërt midis femrave dhe meshkujve.
- Njësitë si Kala e Dodës, Lurë dhe Selishtë kanë popullsi më të ulët (rreth ose më pak se 1,000 banorë), çka mund të ndikojë në organizimin e shërbimeve arsimore dhe sociale për shkak të shpërndarjes gjeografike dhe numrit të kufizuar të banorëve.

Kjo analizë ndihmon në planifikimin e burimeve dhe investimeve për arsimin parauniversitar duke marrë në konsideratë përmasat demografike të komuniteteve lokale.

| *Emri i Njesise Administrative* | Femer | Mashkull | Totali |
|---|---|---|---|
| *Arras* | 915 | 951 | 1866 |
| *Fushë Çidhën* | 1179 | 1199 | 2378 |
| *Kala e Dodës* | 531 | 514 | 1045 |
| *Kastriot* | 2607 | 2615 | 5222 |
| *Lurë* | 244 | 257 | 501 |
| *Luzni* | 849 | 962 | 1811 |
| *Maqellarë* | 4455 | 4250 | 8705 |
| *Melan* | 1495 | 1497 | 2992 |
| *Muhurr* | 850 | 802 | 1652 |
| *Peshkopi* | 7302 | 7408 | 14710 |
| *Selishtë* | 384 | 463 | 847 |
| *Sllovë* | 880 | 881 | 1761 |
| *Tomin* | 3197 | 3334 | 6531 |
| *Zall-Dardhë* | 175 | 244 | 419 |
| *Zall-Reç* | 165 | 170 | 335 |

Popullsia në Bashkinë Dibër përbën një përqindje të konsiderueshme të strukturës demografike, çka tregon për nevojën e theksuar për planifikim të qëndrueshëm në fushën e arsimit dhe shërbimeve sociale.

- **Fëmijët 0–4 vjeç**: Janë 2,829 individë, që përfaqësojnë brezin më të vogël dhe kërkojnë kujdes të veçantë nëpërmjet çerdheve dhe shërbimeve të kujdesit të hershëm.
- **Fëmijët 5–9 vjeç**: Me 3,125 individë, ky grup është objekt i arsimit fillor, duke e bërë të domosdoshëm garantimin e infrastrukturës dhe burimeve për shkollat fillore.

- **Fëmijët 10–14 vjeç:** Janë 3,283 dhe i përkasin ciklit të arsimit bazë, ku nevojitet përforcimi i cilësisë së mësimdhënies dhe mbështetje për përfshirje të barabartë.
- **Të rinjtë 15–19 vjeç:** Me 3,628 persona. ky grup përfaqëson popullsinë në arsimin e mesëm dhe në prag të integrimit në tregun e punës ose arsimin profesional/universitar.

| *Grup-mosha* | **Popullsia** |
|---|---|
| *0-4 vjeç* | 2829 |
| *5-9 vjeç* | 3125 |
| *10-14 vjeç* | 3283 |
| *15-19 vjeç* | 3628 |

## 2. Kuadri ligjor dhe politikat që përcaktojnë bazën referuese për përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor – Bashkia Dibër

Zbatimi i funksioneve të Bashkisë Dibër në fushën e arsimit parauniversitar mbështetet në një kuadër të gjerë kushtetues, ligjor dhe politikash, i cili përcakton të drejtat, detyrimet dhe kompetencat e institucioneve publike në garantimin e së drejtës për arsim për të gjithë qytetarët.

Në krye qëndron Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ku në nenin 57, pika 1, sanksionohet e drejta për arsim. Kjo e drejtë zbatohet përmes Ligjit nr. 69/2012. "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin nr. 48/2018, i cili rregullon strukturën, cilësinë dhe menaxhimin e arsimit nga cikli parashkollor deri te ai i mesëm profesional.

Ligji nr. 139/2015. "Për vetëqeverisjen vendore". i njeh bashkive kompetenca të plota për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e çerdheve dhe kopshteve publike, si dhe role mbështetëse në arsimin bazë e të mesëm, përmes sigurimit të infrastrukturës dhe përfshirjes sociale. Financimi dhe ushtrimi i këtyre funksioneve bëhet në përputhje me Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", dhe Ligjin nr. 9936/2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor".

Ligji nr. 9632/2006. "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, përcakton burimet e ardhurash që mund të përdoren për të mbështetur sektorin e arsimit në territorin e Bashkisë Dibër.

Në nivel zbatimi. funksionimi i institucioneve arsimore në territorin e bashkisë rregullohet nga një sërë aktesh nënligjore. si:

- **Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020** – për rregulloren e funksionimit të institucioneve arsimore;
- **Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023** – për normat e klasave dhe ngarkesën mësimore;
- **Udhëzimi i përbashkët MAS-MEKI nr. 13, datë 10.07.2024** – për organizimin e vitit shkollor 2024–2025;
- **Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018** – për bordet e institucioneve arsimore;
- **Urdhri nr. 199, datë 07.05.2024** – që miraton Komizën e Vlerësimit të Cilësisë për institucionet parashkollore.

Për të garantuar një qasje të barabartë në arsim dhe për të mbrojtur fëmijët në nevojë, Bashkia Dibër udhëhiqet nga:

- **Ligji nr. 121/2016.** "Për shërbimet e kujdesit shoqëror";
- **Ligji nr. 18/2017.** "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës";
- **Udhëzimi nr. 21, datë 08.08.2014**, për rritjen e frekuentimit të shkollës nga fëmijët romë;

- Plani Kombëtar për Romët dhe Egjiptianët 2021–2025.

Gjithashtu, ofrimi i shërbimit psiko-social në shkolla bazohet në Urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020 dhe udhëzuesin për punën e punonjësve sociale, ndërsa Udhëzimi MAS-MShMS nr. 658, datë 23.09.2019 garanton mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në internet.

Nëpërmjet këtij kuadri gjithëpërfshirës, Bashkia Dibër **angazhohet si një aktor kyç në zbatimin** e politikave arsimore dhe sociale, duke bashkëpunuar **ngushtë me** Zyrën Vendore Arsimore, institucionet shkollore dhe partnerët lokalë **për të ndërtuar një sistem arsimor** cilësor, gjithëpërfshirës dhe të qasshëm për çdo fëmijë në **territorin e saj.**

## 3. Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025

### Shpërndarja e dhe mbulimi i shërbimit të institucioneve arsimore në Bashkinë Dibër

Në territorin e Bashkisë Dibër, prania e institucioneve arsimore parauniversitare reflekton një përkushtim për të siguruar akses të gjerë dhe **të barabartë** në edukim për të gjithë fëmijët, pavarësisht vendbanimit të tyre.

◇ Arsimi parashkollor: Në nivel parashkollor, Bashkia Dibër administrohen 73 kopshte të shpërndara në mënyrë të balancuar midis zonave urbane dhe atyre rurale. Kjo shpërndarje gjeografike dëshmon për përpjekjet e vazhdueshme për të afruar shërbimet edukative më pranë komuniteteve, veçanërisht në njësitë administrative me terren të thellë ose më të vështirë.

◇ Institucionet e arsimit bazë dhe **të mesëm**: Në të gjithë territorin funksionojnë 67 shkolla të niveleve të ndryshme (fillore, 9-vjeçare dhe të mesme), të cilat mbulojnë të gjitha njësitë administrative të bashkisë. Ky rrjet shkollor përbën një bazë të rëndësishme për ofrimin e arsimit të detyrueshëm dhe të mesëm, duke garantuar që fëmijët dhe të rinjtë në çdo pjesë të territorit të kenë mundësi të barabarta për arsimim cilësor.

| Njesia Administrative | Numri i Kopshteve | Numri I shkollave |
|---|---|---|
| Nj.a Kala e Dodës | 1 | 1 |
| Nj.a Selishtë | 0 | 3 |
| Nj.a Sllovë | 3 | 2 |
| Nj.a Kastriot | 7 | 7 |
| Nj.a Arras | 3 | 8 |
| Nj.a Luzni | 3 | 3 |
| Nj.a Maqellare | 17 | 15 |
| Nj.a Melan | 10 | 4 |
| Nj.a Muhurr | 4 | 5 |
| Nj.a Peshkopi | 12 | 5 |
| Nj.a Tomin | 7 | 4 |
| Nj.a Zall-Dardhe | 1 | 3 |
| Nja.a Zall-Reç | 0 | 3 |
| Fushë Çidhën | 4 | 2 |

Kjo shpërndarje institucionale nënvizon nevojën për **vazhdimësi në mirëmbajtje, rritje të cilësisë** së mësimdhënies dhe investime infrastrukturore, veçanërisht në zonat më të thella dhe të varfra,

ku sfidat për akses në arsim janë më të theksuara. Një qasje e tillë gjithëpërfshirëse e përforcon rolin e Bashkisë Dibër si garantuese e së drejtës për arsim për çdo fëmijë në territorin e saj.

### Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor

Në Bashkinë Dibër funksionojnë gjithsej 73 kopshte, të shpërndara në mënyrë të ndryshme në 15 njësi administrative,të pozicionuara si në qendra urbane, ashtu edhe në fshatra e zona të thella. Kjo tregon për një angazhim të Bashkisë për të ofruar **akses të decentralizuar dhe gjithëpërfshirës** në edukimin e hershëm.

- **Njësia Administrative Maqellarë** rezulton me numrin më të madh të kopshteve, të shpërndara në vendbanime të ndryshme si: Maqellarë, Herbel, Pocest, Kat i Vogël, Kërçisht i Poshtëm, Kllobçisht, Vojnikë dhe zona të tjera të fshatit si Burim, Matarë dhe Majtare e poshtme. Kjo përfaqëson një shpërndarje të mirë të shërbimit në territor.
- **Peshkopia**, si qendër bashkie, ka një përqendrim të lartë kopshte-sh: si në qendër të qytetit (Kopshti Nr.1 dhe Nr.2 Peshkopi), ashtu edhe në lagje e zona periferike si Dobrov dhe me emra të personalizuar (Demir Gashi, Myslim Shehu, Parashkollori).
- **Kastrioti** shfaq një rrjet të përhapur kopshte-sh që përfshin Kastriot Qendër, Sohodoll, Vakuf, dhe klasat përgatitore në zona të thella.
- Njësitë si Tomin, Melan, Luzni, Fushë-Çidhen, Kala e Dodës dhe Sllovë kanë gjithashtu kopshte funksionale, duke siguruar shërbim në vendbanime si Pollozhan, Brezhdan, Bellovë, Fushë-Alie, Biliçe, Ilnicë, Lishan i Poshtëm, dhe Rashnapoje.
- Ndërkohë, disa kopshtet janë të pozicionuara pranë shkollave 9-vjeçare, duke përmirësuar lidhjen ndërmjet edukimit parashkollor dhe cikleve të mëvonshme.

Njësitë administrative me numrin më të madh të kopshteve janë:

- Maqellarë me 17 kopshte
- Peshkopi me 12 kopshte
- Kastriot me 7 kopshte
- Melan me 10 kopshte




### Frekuentimi në kopshte

Në bashkinë Dibër, sipas të dhënave më të fundit, të INSTAT (Census 2023), numri total i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç është 2104, prej të cilët 1066 janë djem dhe 1038 janë vajza. Nga kjo populsi,

rreth 1211 fëmijë janë të regjistuar dhe frekuentojne institucionet parashkollore (kopshtin), konkretisht 601 djem dhe 610 vajza.
Kjo përfaqëson një përqindje të përgjithshme prej 57.56% të fëmijëve që janë të përfshirë në arsimimin parashkollor.

Të dhënat mbi përfshirjen e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç në arsimin parashkollor tregojnë se në total 57.56% e fëmijëve ndjekin kopshtin. Brenda këtij grupi, përqindja e përfshirjes ndryshon midis gjinive: 56.38% e djemve dhe 58.77% e vajzave janë të përfshirë në edukimin parashkollor.
Këto të dhëna theksojnë rëndësinë e ndërhyrjeve të fokusuara në zgjerimin e aksesit, rritjen e ndërgjegjësimit komunitar dhe përmirësimin e infrastrukturës së arsimit parashkollor, me qëllim garantimin e të drejtës për arsim të barabartë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët e moshës 3–6 vjeç në territorin e Bashkisë Dibër.

- **Kopshte me ushqim:** Vetëm 3 **kopshte** ofrojnë shërbim me ushqim – të dy kopshtet ndodhen në qytetin e Peshkopisë (Kopshti Nr. 1 (Godina 1 dhe Godina 2) dhe Kopshti Nr. 2), duke përfaqësuar një përqendrim të shërbimit ushqimor vetëm në qendër urbane.

- **Kopshte pa ushqim:** Të gjitha kopshtet e tjera (rreth 86 **institucione**) janë kopshte pa drekë kryesisht në njësitë administrative, në fshatra.

**Analizë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbështetjen e ofruar**

- Në total janë evidentuar:
  - 15 fëmijë me aftësi të kufizuara mendore, të **shpërndarë në:**
    - Melan (10),
    - Maqellarë (4),
    - Kastriot (1)
  - 6 fëmijë me aftësi të kufizuara fizike**, të përqendruar në:**
    - Melan (5),
    - Maqellarë (1)

**Mbështetja e dedikuar**

- Është i nevojshëm shtimi i mësuesve ndihmës:
- Shërbimi psiko-social: në katër kopshte fëmijët dhe fëmijet janë mbështetur me shërbim prosko-social:
  - Melan (2)
  - Zall Dardhë (1)
  - Pushë-Çidhen (1)

**Fëmijë nga familje egjiptiane**

- Në total janë evidentuar 38 fëmijë egjiptianë në nivel bashkie.
- Përqendrimi më i madh është në:
  - Peshkopi – me 24 fëmijë
  - Kastriot – me 10 fëmijë
  - Maqellarë – me 4 fëmijë

Përqendrimi i fëmijëve egjiptianë në pak njësi tregon për nevojën që këto zona të jenë në fokus për politika të përfshirjes.

### Fëmijë nga familje me ndihmë ekonomike

- Totali i fëmijëve nga familje me ndihmë ekonomike është **370**, shpërndarë gjerësisht në të gjitha njësitë.
- Zonat me përqendrimin më të lartë janë:
  - Maqellarë – 89 fëmijë
  - Kastriot – 85 fëmijë
  - Peshkopi – 83 fëmijë
  - Melan – 32 fëmijë
  - Luzni – 20 fëmijë

Shpërndarja tregon një përfshirje të konsiderueshme të fëmijëve në nevojë, veçanërisht në qendrat më të populluara dhe në zonat me sfida të mëdha socio-ekonomike.

## 4. Analiza e shërbimit të në shkolla bazë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024 – 2025

### Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit (shkollat)

Shkollat në territorin e Bashkisë janë të organizuara dhe të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë sa më mirë nevojat arsimore të komunitetit. Ato klasifikohen në disa nivele sipas ciklit të edukimit që ofrojnë, duke përfshirë: shkolla fillore (19 gjithsej), shkolla 9-vjeçare (39 gjithsej) dhe shkolla të mesme (9 gjithsej).

- **Shkollat fillore** u shërbejnë fëmijëve në fazat e para të edukimit, duke u ofruar njohuritë bazë në lexim, shkrim, matematikë dhe lëndë të tjera themelore. Ato janë të përhapura në mënyrë të tillë që të jenë sa më pranë vendbanimeve për të siguruar akses të lehtë për nxënësit e vegjël.
- **Shkollat 9-vjeçare**, gjithsej 39 në numër, përfshijnë si ciklin fillor, ashtu edhe atë të mesëm të ulët, dhe janë projektuar për të ofruar një arsim të plotë bazë. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin akademik dhe shoqëror të nxënësve dhe përgatitjen e tyre për nivelin e ardhshëm arsimor.

**Shkollat e mesme**, me numër prej 9, që përfshijnë gjimnazet dhe 1 shkolle profesionale, janë institucione që synojnë të formojnë të rinjtë për studime të mëtejshme universitare apo për përgatitje për tregun e punës. Këto shkolla janë të vendosura në zona strategjike për të përfshirë një numër sa më të madh nxënësish nga zona të ndryshme të bashkisë.



Frekuentimi në arsimin fillor

| Gjinia | Numri i Nxënësve | Përqindja (%) |
|---|---|---|
| Djem | 1545 | 51.67 |
| Vajza | 1445 | 48.33 |
| Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin fillor | 2990 | |

Në arsimin fillor janë të regjistruar gjithsej 2990, nga të cilët 1545 janë djem dhe 1445 vajza. Sipas të dhënave të raportuara, 51.67% e tyre janë djem dhe 48.33% vajza. Kjo ndarje reflekton situatën e përfshirjes në këtë nivel arsimor, e cila ndryshon nga njësi në njësi, në varësi të kushteve lokale, demografisë, dhe mundësive të ofruara në komunitet. Të dhënat nënvizojnë rëndësinë e vazhdimit të përpjekjeve për të garantuar akses të barabartë dhe gjithëpërfshirës në arsimin fillor për të gjithë fëmijët, pavarësisht vendbanimit apo karakteristikave të tjera sociale. Sigurimi i kushteve të përshtatshme për ndjekjen e shkollës dhe mbështetja institucionale mbeten faktorë kyç për përmirësimin e mëtejshëm të përfshirjes.

Frekuentimi arsimi 9-vjeçar

Në arsimin 9-vjeçar janë të regjistruar gjithsej 2597 nxënës, prej të cilëve 1342 janë djem dhe 1255 vajza. Sipas të dhënave, 51.68% e nxënësve janë djem dhe 48.32% janë vajza. Kjo shpërndarje pasqyron situatën aktuale të përfshirjes në këtë nivel arsimor, e cila ndryshon nga njësi në njësi dhe ndikohet nga faktorë të ndryshëm lokalë. Pavarësisht variacioneve, këto të dhëna nënvizojnë rëndësinë e monitorimit të rregullt të pjesëmarrjes së fëmijëve në arsim dhe nevojën për politika që mbështesin vazhdimësinë e shkollimit për të gjithë. Sigurimi i kushteve të favorshme për ndjekjen e arsimit 9-vjeçar është thelbësor për garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të barabartë për çdo fëmijë.

| Gjinia | Numri i Nxënësve | Përqindja (%) |
|---|---|---|
| Djem | 1342 | 51.68 |
| Vajza | 1255 | 48.32 |
| Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin 9 - vjeçar | 2597 | |

Frekuentimi arsimi i mesëm

| Gjinia | Numri i Nxënësve | Përqindja (%) |
|---|---|---|
| Djem | 902 | 48.97 |
| Vajza | 940 | 51.03 |
| Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin e mesëm | 1842 | |

Në arsimin e mesëm janë të regjistruar gjithsej 1842 nxënës, nga të cilët 902 janë djem dhe 940 vajza, përkatësisht 48.97% djem dhe 51.03% vajza. Ndarja gjinore në këtë nivel arsimor pasqyron situatën e raportuar për njësinë përkatëse, por këto përqindje mund të jenë të ndryshme në zona të tjera. Shpërndarja e pjesëmarrjes në arsimin e mesëm ndikohet nga faktorë të shumtë si zgjedhjet individuale, mundësitë për të ndjekur shkolla të përgjithshme apo profesionale, si dhe faktorë socialë, ekonomikë apo kulturorë. Kjo e bën të nevojshme që të mbështetet përfshirja e vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse në këtë nivel të rëndësishëm të arsimit.

## 5. Analiza edhe shperndarja e stafit arsimor në territorin e bashkisë

Shkolla

| Njësia administrative | Punonjës sanitarë | Roje | Punonjës shërbimesh mbështetëse |
|---|---|---|---|
| Peshkopi | 29 | 11 shkolle+kopesht | 1 |
| Tomin | 3 shkolle+kopesht | 2 shkolle+kopesht | |
| Melan | 1 shkolle+kopesht | 0 | |
| Kastriot | 2 shkolle+kopesht | 1 | 1 |
| Lure | 0 | 0 | |
| Maqellare | 0 | 1 | 1 |
| Luzni | 0 | 0 | |
| Selishte | 0 | 0 | |
| Kala-Dodes | 1 kopesht+shkolle | 0 | |
| Sllove | 1 kopesht+shkolle | 0 | |
| Zall-Dardhe | 0 | 0 | |
| Zall-Reç | 0 | 0 | |
| Fush-Çidhen | 2 kopesht+shkolle | 0 | |
| Muhurr | 1 kopesht+shkolle | 0 | |
| Arras | 2 kopesht+shkolle | 0 | |

Në njësitë administrative të Bashkisë Dibër, shpërndarja e stafit arsimor dhe ndihmës në institucionet arsimore parauniversitare pasqyron struktura të ndryshme në varësi të përmasave të territorit, numrit të institucioneve dhe kërkesës komunitare.

Në total, janë angazhuar 73 edukatore në kopshte, të cilët sigurojnë procesin edukativ të fëmijëve në nivel parashkollor dhe fillor. Ndërsa 4 mësues **ndihmës** janë të pranishëm në disa institucione specifike, për të mbështetur integrimin dhe zhvillimin individual të fëmijëve me nevoja të veçanta ose në grupe me ngarkesë të lartë. Nga ana tjetër, 77 **punonjës ndihmës**, përfshirë pastrues, roje, dhe punonjës shërbimi, **(nga ate cilet 25 sanitare jane ne godinat me vete te kopshteve dhe 1 magaziniere kurse 13 rojet jane edhe per kopshtet, edhe per shkollat)**, garantojnë funksionimin e përditshëm të institucioneve dhe mbështesin sigurinë, higjienën dhe mirëqenien e fëmijëve.

Shpërndarja e këtyre burimeve njerëzore është e njëtrajtshme ndërmjet njësive administrative sipas nevojës dhe madhësisë së institucioneve, llojit të shërbimit të kërkuar.

Kopshte

| Njësia administrative | Edukatorë | Mësuese ndihmëse | Punonjës sanitarë | Roje | Punonjës shërbimesh mbështetëse |
|---|---|---|---|---|---|
| Peshkopi | 73 | 2 | 53 nga keto 25 jane ne godinat me vete | 10 | 1 |
| Tomin | 12 | 0 | 3 kopesht+shkolle | 2 | 0 |
| Melan | 12 | 0 | 1 kopesht+shkolle | 0 | 0 |
| Kastriot | 12 | 1 | 2 kopesht+shkolle | 0 | 0 |
| Lure | 7 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Maqellare | 22 | 1 | 0 | 0 | 0 |
| Luzni | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Selishte | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kala-Dodes | 3 | 0 | 1 kopesht+shkolle | 0 | 0 |
| Sllove | 2 | 0 | 1 kopesht+shkolle | 0 | 0 |
| Zall-Dardhe | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Zall-Rec | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Fush-Çidhen | 6 | 0 | 2 kopesht+shkolle | 0 | 0 |
| Muhurr | 5 | 0 | 1 kopesht+shkolle | 0 | 0 |
| Arras | 3 | 0 | 2 kopesht+shkolle | 0 | 0 |

## 6. Shërbimi i Arsimit sipas njësive administrative

**Njësia Administrative: Peshkopi**

**Shkollat**

Në total, funksionojnë 8 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 2 shkolla janë në ciklin fillor, ndërsa 4 prej tyre janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, 1 është shkolla të mesme dhe 1 është shkollë e mesme profesionale për t'u dhënë të rinjve mundësinë për të vijuar me arsimin e lartë apo për të hyrë në tregun e punës me përgatitje profesionale.

Përmes këtij sistemi, njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimimit dhe mirëqenies sociale.
Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale.

**Lista e shkollave përfshin:**

| Emri i Shkolles |
|---|
| "Demir Gashi" |
| "Demir Gashi (Arsim Fillor) |
| "Irfan Hajrullai" |
| "Selim Alliu" (Arsim Fillor) |
| "Myslim Shenu" |

| |
|---|
| Shkolla e mesme profesionale "Nazmi Rushit" |
| "Said NAjdeni" |
| "Selim Alliu" |

**Kopshtet**

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 11 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

Lista e **kopshteve përfshin:**

| **Emri i kopshtit** |
|---|
| "Demir Gashi" |
| "Selim Alliu" |
| "Myslim Shehu" |
| Kallavere |
| "Irfan Hajrullahi" |
| "Kamen" |
| Nr.1 |
| Nr. 2 |
| Qender |
| Llixha |
| Dobrovë |

**Njësia Administrative: Tomin**

**Shkollat**

Në Njësinë Administrative Tomin funksionojnë gjithsej katër shkolla, të cilat përbëjnë bazën e rrjetit arsimor për komunitetin lokal. Nga këto institucione, njëra është shkollë fillore, ndërsa tre të tjera janë shkolla 9-vjeçare, që mbulojnë ciklin e plotë të arsimit bazë.

Ky rrjet institucional është i shpërndarë në mënyrë që të mundësojë akses të qëndrueshëm për fëmijët në të gjitha zonat e njësisë, duke përfshirë qendrat e banuara, por edhe fshatrat më të largëta. Kjo shpërndarje synon të ulë pengesat gjeografike dhe sociale për ndjekjen e arsimit dhe të forcojë angazhimin e hershëm dhe të vazhdueshëm në procesin edukativ.

Përmes këtij sistemi, Tomin siguron bazat për zhvillimin njerëzor dhe komunitar, duke kontribuar në përmirësimin e shkallës së arsimimit, integrimin social dhe përgatitjen e brezit të ri për një jetë aktive dhe të qëndrueshme. Mungesa e shkollës së mesme mbetet një boshllëk që kërkon adresim për të garantuar vazhdimësi të arsimit dhe barazi në mundësi.

Lista e **shkollave përfshin:**

| **Emri i Shkollës** |
|---|
| Dohoshisht |
| "Idriz Kaba" |
| "Isuf Karasani" |
| Shimçan |

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 7 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Lista e kopshteve përfshin:

| Emri i kopshtit |
| --- |
| Pollozhan |
| Isuf Karasani |
| Idriz Kaba |
| Rashnapoje |
| Pilafe |
| Dohoshisht |
| Shimçan |

Njësia Administrative: Melan

Shkollat

Në territorin e Njësisë Administrative Melan operojnë pesë shkolla, të cilat janë të vendosura në mënyrë të tillë që të përmbushin nevojat arsimore të komunitetit vendas. Nga këto institucione, njëra është shkollë fillore, ndërsa katër të tjera janë shkolla 9-vjeçare, që ofrojnë të gjithë ciklin e arsimit bazë.

Kjo strukturë mundëson ofrimin e shërbimeve arsimore në një territor të gjerë, duke u përpjekur të garantojë që fëmijët të kenë akses të rregullt në shkollim, pavarësisht nëse jetojnë në qendra të banuara apo në zona më të largëta dhe rurale.

Prania e këtyre shkollave përbën një shtyllë të rëndësishme për zhvillimin social dhe edukativ të komunitetit, duke ndikuar pozitivisht në ngritjen e nivelit të arsimimit dhe përgatitjen e brezave të rinj për të ardhmen.

Lista e shkollave përfshin:

| Emri i Shkolles |
| --- |
| Melan |
| "Shemsi Haka" |
| "Alush Bunguri" |
| Ilnice |
| "Haki Stermilli" |

Kopshtet

Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 10 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Lista e kopshteve përfshin:

| Emri i kopshtit |
| --- |
| "Shemsi Haka" |
| Shkolla "Haki Stërmilli" Ilnicë |
| Shkolla"Haki Stermilli"Melan |
| Shkolla"Shemsi Haka" |
| Kopështi Pejkë, Melan |
| Trepçe |
| Trene |

| |
|---|
| Pjeçe |
| Rabdisht |
| Begjunec |

**Njësia Administrative: Kastriot**

**Shkollat**

Në Njësinë Kastriot funksionojnë gjithsej 7 shkolla, të strukturuara për të mbuluar në mënyrë efektive nevojat arsimore të komunitetit. Prej tyre, 1 shkollë ofron ciklin fillor, 5 janë shkolla 9-vjeçare që mbulojnë të gjithë ciklin bazë të arsimit parauniversitar, dhe 1 shkollë e mesme ofron mundësi për vijimësi në arsimin e lartë apo përgatitje për tregun e punës me orientim profesional.

Kjo strukturë shkollore krijon një rrjet arsimor funksional, që synon të sigurojë akses të vazhdueshëm në arsim për fëmijët dhe të rinjtë, si në zonat qendrore të banuara, ashtu edhe në lagje periferike dhe fshatra të largët.

Nëpërmjet këtij rrjeti, njësia kontribuon në rritjen e nivelit të arsimimit, përfshirjen sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit lokal, duke vendosur një bazë të fortë për mirëqenien dhe mundësitë afatgjata për brezat e rinj.

**Lista e shkollave përfshin:**

| **Emri i Shkolles** |
|---|
| "Gjergj Kastrioti" |
| Vakuf |
| Vranjt |
| Sohodol |
| Kander |
| 9-vjeçare, Kastriot |
| Sohodoll i madh |

**Kopshtet**

Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 7 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

**Lista e kopshteve përfshin:**

| **Emri i kopshtit** |
|---|
| Kander |
| Kastriot |
| Kastriot Qendër |
| Sohodoll |
| Vakuf |
| Vranjt |
| Sohodoll |

Njësia Administrative: Maqellarë

Shkollat

Në territorin e njësisë Maqellarë funksionojnë gjithsej 15 shkolla, të organizuara për të përmbushur në mënyrë të plotë kërkesat arsimore të komunitetit. Nga këto, 8 janë shkolla fillore, që ofrojnë mësim në klasat e para të arsimit bazë; 6 janë shkolla 9-vjeçare, të cilat mbulojnë ciklin e plotë të arsimit të detyrueshëm; dhe 1 është shkollë e mesme, e cila u krijon të rinjve mundësi për të ndjekur arsimin e mëtejshëm apo për të hyrë të përgatitur në tregun e punës.

Kjo rrjetë shkollore garanton shërbime arsimore të shpërndara në mënyrë të barabartë, duke përfshirë si zonat qendrore, ashtu edhe ato më të largëta dhe rurale, me qëllim që çdo fëmijë të ketë akses të rregullt në arsim cilësor.

Lista e shkollave përfshin:

| Emri i Shkolles |
|---|
| "Fiqiri Dine" |
| Kërçisht i siperm |
| Majtarë |
| Maqellarë |
| Pocest |
| Vojnikë |
| Shkolla "Kamber XhafaKovashice" |
| Kllobçisht |
| Erebare |
| Herbel |
| Dovolan |
| Grezhdan |
| Burim |
| Bllate e poshtme |
| Kerçisht i poshtem |

Kopshtet

Në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 17 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Lista e kopshteve përfshin:

| Emri i kopshtit |
|---|
| Maqellarë |
| Herbel |
| Kerçisht i Poshtëm |
| Pocest |
| Kërçisht |
| Kat i Vogël |
| Vojnikë |
| Majtare e poshtme |
| Nr 1 Majtare |
| Burim |
| Grezhdan |
| Dovalan |
| Herbel |
| Erebare |
| Kllobçisht |

| |
|---|
| Kovashice |

**Njësia Administrative: Luzni**

**Shkollat**

Në Njësinë administrative Luzni, funksionojnë 3 shkolla. Nga këto, 1 shkollë në ciklin fillor, ndërsa 2 të tjera janë shkolla 9-vjeçare.

Lista e shkollave përfshin:

| Emri i Shkolles |
|---|
| Katundi i Ri |
| Luzni |
| Hotesh |

**Kopshtet**

Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 3 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Lista e kopshteve përfshin:

| Emri i kopshtit |
|---|
| 9-vjeçare "Katund i Ri" |
| "Fiqiri Cani" |
| Hotesh |

**Njësia Administrative: Selishtë**

**Shkollat**

Në këtë njësi administrative janë funksionale **3 shkolla**, të cilat janë të shpërndara në mënyrë që të përgjigjen ndaj nevojave arsimore të komunitetit. **2 shkolla janë të ciklit 9-vjeçar**, që mbulojnë arsimin bazë për fëmijët e zones.

Lista e shkollave përfshin:

| Emri i Shkolles |
|---|
| Selishtë |
| "Tahir Losha", Lunare |
| Qafe-Murre |

**Njësia Administrative: Sllovë**

**Shkollat**

Në Njësinë Administrative Sllovë janë në funksion 2 shkolla, të vendosura në mënyrë që të përmbushin nevojat arsimore të komunitetit. Prej funksion tyre, 1 shkollë është 9-vjeçare, që ofron arsimin bazë për fëmijët e zonës, ndërsa 1 shkollë është e mesme, duke krijuar mundësi për të rinjtë që të vazhdojnë arsimimin ose të përgatiten për tregun e punës.

Lista e shkollave përfshin:

| Emri i Shkolles |
|---|
| "Hasan Leka" |
| Shkolla e Mesme e Bashkuar "Ajet Ndreu", Sllove |

**Kopshtet**

Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 3 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

**Lista e kopshteve përfshin:**

| **Emri i kopshtit** |
|---|
| "Ajet Ndreu" |
| Shumbat |
| Kalie |

**Njësia Administrative: Kala e Dodës**

**Shkollat**

Në këtë njësi funksionon vetëm një shkollë 9-vjeçare, e cila mbulon ciklin bazë të arsimit për fëmijët e zonës.

Lista e shkollave përfshin:

| **Emri i Shkolles** |
|---|
| "Ibrahim Gjorgji" |

**Kopshtet**

Në fushën e kujdesit dhe edukimit të hershëm, funksionon 1 kopsht parashkollor, i cili gjithashtu mban emrin "Ibrahim Gjorgji". Ky institucion ofron edukim dhe përkujdesje për fëmijët e moshës 3–6 vjeç, duke përmbushur një funksion të rëndësishëm në përgatitjen për shkollë dhe mbështetjen e familjeve të komunitetit.

**Lista e kopshteve përfshin:**

| **Emri i kopshtit** |
|---|
| "Ibrahim Gjorgji" |

**Njësia Administrative: Zall-Dardhë**

**Shkollat**

Në Zall-Dardhë funksionojnë gjithsej 3 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë që të përmbushin nevojat arsimore të komunitetit lokal. Dy janë shkolla 9-vjeçare, dhe 1 është shkollë e mesme e bashkuar, e cila ofron mundësi për të rinjtë të vazhdojnë arsimin pas ciklit bazë dhe të përgatiten për vijimin e shkollimit të lartë ose për futje të hershme në tregun e punës.

Struktura ekzistuese e shkollave mbulon një spekter të gjerë të cikleve arsimore dhe është pozicionuar në mënyrë të tillë që të mundësojë akses të vazhdueshëm për fëmijët dhe të rinjtë, si në vendbanimet qendrore, ashtu edhe në zonat më të thella dhe rurale të njësisë.

**Lista e shkollave përfshin:**

| **Emri i Shkolles** |
|---|
| Shkolla e Mesme e Bashkuar Zall - Dardhë |
| Zall-Dardhe Tartaj |
| Zall-Dardhe Lugjej |

**Kopshtet**

Pjesë e shërbimeve arsimore është edhe edukimi i hershëm. Aktualisht, në këtë njësi funksionon 1 kopsht, i vendosur pranë shkollës së mesme të bashkuar Zall-Dardhë. Ky institucion ofron edukim

për fëmijët e moshës 3–6 vjeç dhe kontribuon si në zhvillimin e hershëm të fëmijëve, ashtu edhe në mbështetjen e prindërve dhe familjeve, duke lehtësuar përfshirjen sociale dhe përgatitjen për arsimin bazë. Lista e kopshteve përfshin:

| **Emri i kopshtit** |
|---|
| Shkolla e Mesme e Bashkuar Zall - Dardhë |
| |

**Njësia Administrative: Zall-Reç**

**Shkollat**

Në Zall-Reç janë funksionale 3 **shkolla**, të gjitha të nivelit **9-vjeçar**, të cilat ofrojnë ciklin bazë të arsimit për fëmijët e komunitetit.

**Lista e shkollave përfshin:**

| **Emri i Shkolles** |
|---|
| Sh.M.B Zall-Dardhe Zall-Reç |
| Hurdhe -Reç |
| Sh.M.B Zall-Dardhe Arat e poshtme |
| |

**Njësia Administrative: Fushë Çidhën**

**Shkollat**

Në këtë njësi funksionojnë gjithsej **2 shkolla 9-vjeçare**, të cilat përmbushin nevojat e komunitetit për arsimin bazë..

**Lista e shkollave përfshin:**

| **Emri i Shkolles** |
|---|
| Bllicë |
| "Sali Demiri" |
| |

**Kopshtet**

Në Fushë Çidhën janë të hapura 2 kopshte, të cilat shtrihen në zona të ndryshme për të garantuar përfshirje të gjerë të fëmijëve të moshës 3–6 vjeç. Këto institucione ofrojnë edukim të hershëm cilësor dhe mbështetje zhvillimore, duke ndihmuar fëmijët në përgatitjen për shkollë dhe duke lehtësuar barrën e kujdesit për prindërit.

**Lista e kopshteve përfshin:**

| **Emri i kopshtit** |
|---|
| Nr. 2 Grupi Yjeve |
| Bllice |
| "Sali Demiri" |
| Laçes |
| |

**Njësia Administrative: Arras**

**Shkollat**

Në këtë njësi administrative funksionojnë gjithsej 8 shkolla, të shpërndara në mënyrë të tillë që të garantojnë mbulim arsimor të vazhdueshëm për komunitetin lokal. Struktura e këtyre institucioneve është si vijon:

- **4 shkolla fillore**, të cilat ofrojnë edukimin në ciklin e ulët të arsimit bazë.
- **3 shkolla 9-vjeçare**, që mbulojnë ciklin e plotë të arsimit të detyrueshëm.

- **1 shkollë e mesme**, që ofron mundësi për vazhdim të shkollimit dhe përgatitje për integrim në tregun e punës ose ndjekje të studimeve të larta.

Ky rrjet institucional është vendosur në mënyrë të balancuar në territor, duke garantuar akses të barabartë në arsim për fëmijët dhe të rinjtë, si në vendbanimet qendrore, ashtu edhe në zonat periferike apo më të largëta. Kjo shpërndarje siguron lehtësim të ndjekjes së shkollës, veçanërisht për nxënësit që përballen me vështirësi ekonomike ose gjeografike.

**Lista e shkollave përfshin:**

| Emri i Shkolles |
|---|
| Grykë – Noke |
| "Hakik Xhika" Mustafë |
| SHMB Arras |
| Sinë e poshtme |
| Sine e Sipërme |
| Gur i zi |
| Karriq |
| Çidhen |

**Kopshtet**

Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 3 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

**Lista e kopshteve përfshin:**

| Emri i kopshtit |
|---|
| Arras |
| Çidhen |
| Sine |

**Njësia Administrative: Muhurr**

**Shkollat**

Në territorin e kësaj njësie administrative janë të funksionale gjithsej **5 shkolla**, të shpërndara në mënyrë të tillë që të përmbushin nevojat arsimore të komunitetit vendas. Struktura arsimore përfshin:

- **4 shkolla fillore**, të cilat ofrojnë ciklin e ulët të arsimit bazë dhe sigurojnë themelet e para të edukimit.
- **1 shkollë të mesme**, e cila u jep të rinjve mundësi të ndjekin arsimin e mëtejshëm dhe të pajisen me njohuri për të hyrë në tregun e punës ose për të vijuar studimet e larta.

**Lista e shkollave përfshin:**

| Emri i Shkolles |
|---|
| SHMB "Dine Hoxha" Muhurr |
| Sharakan |
| Rreth-Kale |
| Hurdhë -Muhurr |
| Bulaç |

Kopshtet
Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 4 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.
Lista e kopshteve përfshin:

| **Emri i kopshtit** |
|---|
| Muhurr |
| Kreth-Kale |
| Vajmidhej |
| Hurdhë -Muhurr |

## 7. Vizioni, qëllimet strategjike, objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar



**Vizioni**

*"Bashkia Dibër synon të zhvillojë një sistem arsimor parauniversitar gjithëpërfshirës, cilësor dhe të aksesueshëm, që u garanton të gjithë fëmijëve dhe të rinjve mundësi të barabarta për të mësuar, për t'u rritur dhe për të ndërtuar të ardhmen e tyre në një mjedis të sigurt, modern dhe nxitës. Nëpërmjet investimeve të planifikuara në përmirësimin e infrastrukturës, rikonstruksionin e shkollave dhe kopshteve, si dhe pajisjen e tyre me mjete bashkëkohore didaktike e teknologjike, vizioni synon të krijojë institucione arsimore funksionale dhe të mirëmenaxhuara në çdo cep të territorit – nga qendra urbane deri në zonat më të thella rurale. Ky vizion udhëhiqet nga bindja se arsimi është themeli i zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të mirëqenies sociale dhe rritjes së mundësive për çdo qytetar të Bashkisë Dibër."*

Vizioni për arsimin parauniversitar në Dibër mbështetet në këto shtylla:

- **Përmirësimi i infrastrukturës** përmes rikonstruksionit të shkollave ekzistuese (si "Irfan Hajrullaj", "Demir Gashi" dhe shkolla e fshatit Sllovë), si dhe ndërhyrjeve të përhapura për riparime dhe përmirësim të objekteve arsimore në gjithë territorin.
- **Fuqizimi i institucioneve parashkollore**, përmes rikonstruksionit të kopshteve në Maqellarë dhe lagjen Kamen, pajisjes së tyre me mjete didaktike, mobilim dhe elementë higjieno-sanitarë, si dhe ndërtimit të një projekti të ri investues në fushën e arsimit.
- **Përmirësimi i cilësisë së mjediseve mësimore**, përmes zëvendësimit të elementëve të amortizuar si dyer, dritare e mobilim në objektet arsimore dhe kulturore.

**Përmbledhje e Qëllimeve, Objektivave dhe Aktiviteteve**

**Qëllimi 1** Modernizimi dhe funksionalizimi i infrastrukturës arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë Dibër, për të garantuar një mjedis të sigurt, të aksesueshëm dhe gjithëpërfshirës në procesin mësimor.

**Objektivat specifike:**

- **Objektivi 1.1:** Sigurimi i kushteve të qëndrueshme për funksionimin e përditshëm të kopshteve dhe shkollave, përmes mobilizimit të stafit të kualifikuar, garantimit të ngrohjes, pastërtisë, transportit, ushqimit dhe furnizimeve bazë.
- **Objektivi 1.2:** Realizimi i ndërhyrjeve në infrastrukturën ekzistuese (rikonstruksion, riparime, sistemet e ngrohjes), pajisja me mjete bashkëkohore, si dhe përmirësimi i mjediseve të mësimdhënies dhe menaxhimit shkollor.

**Qëllimi 2** Përmirësimi i cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në arsimin parashkollor dhe atë bazë, me fokus në zhvillimin profesional të stafit dhe përkrahjen e fëmijëve me nevoja të veçanta.

**Objektivat specifike:**

- **Objektivi 2.1:** Zgjerimi i shërbimeve mbështetëse si mësues ndihmës, psikologë dhe punonjës socialë, për të mundësuar edukim të barabartë për çdo fëmijë, veçanërisht ata me aftësi ndryshe.
- **Objektivi 2.2:** Thellimi i bashkëpunimit midis institucioneve arsimore, prindërve dhe komunitetit përmes strukturave këshillimore dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje.
- **Objektivi 2.3:** Forcimi i bashkëpunimit mes shkollës/kopshtit, familjes dhe komunitetit, përmes strukturave këshilluese dhe aktiviteteve sensibilizuese për rritjen e pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe në jetën institucionale

**Qëllimi 3** Nxitja e zhvillimit kulturor, social dhe emocional të fëmijëve nëpërmjet aktiviteteve jashtë kurrikulës dhe përfshirjes komunitare.

**Objektivat specifike:**

- **Objektivi 3.1:** Organizimi i veprimtarive kulturore, sportive dhe artistike në institucionet arsimore, në partneritet me institucionet e tjera lokale, organizata rinore, artistike dhe sportive për të nxitur talente dhe zhvillimin e integrimin e gjithanshëm te fëmijëve.

**Përmbledhje e investimeve kapitale (2026–2028)**

Investimet kapitale të planifikuara synojnë përmirësimin rrënjësor të infrastrukturës arsimore dhe përmbushjen e standardeve të një mjedisi bashkëkohor, gjithëpërfshirës dhe të sigurt për fëmijët dhe të rinjtë e Bashkisë Dibër.

Plani parashikon një sërë ndërhyrjesh që përfshijnë:

- Rikonstruksionin e shkollave 9-vjeçare "Irfan Hajrullaj", "Demir Gashi" dhe shkollës së fshatit Sllovë, për të garantuar kushte më të mira për zhvillimin e procesit mësimor.
- Riparime të vazhdueshme në godinat arsimore të Bashkisë Dibër, si pjesë e mirëmbajtjes afatmesme të infrastrukturës ekzistuese.
- Rikonstruksionin e kopshteve në Maqellarë dhe lagjen Kamen, për të ofruar një ambient të përshtatshëm për edukimin dhe zhvillimin e hershëm të fëmijëve.
- Blerjen dhe vendosjen e dyerve dhe dritareve në objektet arsimore dhe social-kulturore, duke përmirësuar ndjeshëm sigurinë, funksionalitetin dhe efikasitetin energjetik të institucioneve.
- Furnizimin me pajisje për kopshtet, konviktin dhe çerdhet e qytetit, duke përforcuar bazën materiale për ofrimin e shërbimeve edukative cilësore.
- Hartimin dhe zbatimin e një projekti të ri investimi në fushën e arsimit, me qëllim zhvillimin strategjik të infrastrukturës dhe teknologjisë në institucionet arsimore.

Këto investime përfaqësojnë një angazhim të qartë të Bashkisë Dibër për të garantuar standarde të përmirësuara në edukimin publik dhe për të ndërtuar institucione që përmbushin nevojat e brezit të ardhshëm.

## 8. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar

**Të ardhurat vendore dhe transferimet nga qeveria qendrore për shërbimin e arsimit parauniversitar**

**Të dhënat financiare për shërbimin e arsimit parauniversitar**

Ky seksion përmbledh informacionin financiar që lidhet me funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të arsimit parauniversitar në nivel bashkie.

Bashkia siguron financim për arsimin bazuar në të ardhurat përmes transfertave specifike dhe të përgjithshme të siguruara nga qeveria qendrore si dhe nga taksat dhe tarifat vendore. Transferimet specifike mbulojnë zërat e mëposhtëm:

- Arsimi parashkollor: përfshirë pagat e stafit arsimor dhe ndihmës, kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimin e infrastrukturës së kopshteve, si dhe mbështetjen për përfshirje të fëmijëve nga grupe vulnerabël.
- Arsimi 9-vjeçar Arsimi i mesëm: përfshirë pagat për punonjësit ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së shkollave;
- Arsimi profesional përfshin ofrimin e shërbimet për nxënësit e arsimit professional që frekuentojnë dhe konvikin;

Të dhënat financiare janë të raportuara në mijë lekë dhe pasqyrojnë kontributin për secilën kategori për vitin aktual. si dhe për vitet e mëparshme për të mundësuar analizë krahasimore.

**Buxheti që mbështetë Planin për Arsimin bazë përfshirë arsimin parashkollor**

Buxheti që mbështet planin për zhvillimin e arsimit të mesëm të përgjithshëm, për shpenzime personeli dhe shpenzime korrente dhe investime për periudhën 2026–2028 arrin në 855,443.00 mijë lekë, të detajuara si më poshtë:

| EMËRTIMI i LLOGARISË<br>në mijë lekë | Viti 2026 | Viti 2027 | Viti 2028 |
|---|---|---|---|
| Shpenzime Personeli (600-601) | 223,054 | 222,563 | 223,546 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 45,673 | 47,652 | 47,755 |
| Shpenzime Kapitale (230 – 232, 255) | 14300 | 15,400 | 15500 |

**Buxheti që mbështetë Planin për Arsimin e mesëm të përgjithshëm**

Buxheti që mbështet planin për zhvillimin e arsimit të mesëm të përgjithshëm, për shpenzime personeli dhe shpenzime korrente dhe investime për periudhën 2026–2028 arrin në 133,346.00 mijë lekë, të detajuara si më poshtë:

| EMËRTIMI i LLOGARISË<br>në mijë lekë | Viti 2026 | Viti 2027 | Viti 2028 |
|---|---|---|---|
| **Shpenzime Personeli (600-601)** | 34,000 | 34,200 | 34,500 |
| **Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)** | 7,294 | 11,594 | 11,758 |
| **Shpenzime Kapitale (230 – 232, 255)** | 0 | 0 | 0 |

## 9. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)

**Qëllimi 1 (Q1)** Modernizimi dhe funksionalizimi i infrastrukturës arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë Dibër, për të garantuar një mjedis të sigurt, të aksesueshëm dhe gjithëpërfshirës në procesin mësimor.

| Objektivi O1.1 Sigurimi i kuadrove të qëndrueshme për funksionimin e përditshëm të kopshteve dhe shkollave, përmes mobilizimit të stafit të kualifikuar, garantimit të ngrohjes, pastërtisë, transportit, ushqimit dhe inventarëve bazë. | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitete** | **Periudha e zbatimit** | **Përgjegjës** | **Partnerë** | **Burimet financiare** | **Tregues** |
| Sigurimi i vazhdueshëm i<br>• personelit të arsimit parashkollor (edukatore + staf mbështetës),<br>• Personelit ndihmës në shkollat e arsimit bazë<br>• dhe personelit ndihmës në shkollat e arsimit të mesëm dhe konviktin<br>për të garantuar funksionimin e shkollave dhe kopshteve në admiinistrimine bashkkisë Dibër | 2026–2000028 | Njësia përgjegjëse për arsimin, | Këshilli Bashkiak | Transfertë specifike + Buxhet vendor Perfshire ne zerin *"Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli"* dhe *"Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore"* | Numër kopshte<br>Nr. i personelit edukativ të arsimit parashkollor;<br>Nr. i stafit mbështetës në arsimin parashkollor, arsimin bazë dhe atë të mesëm;<br>Nr. i fëmijëve të regjistruar në kopësht (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) që përfitojnë shërbimi i arsimit parashkollor;<br>Nr, i fëmijëve të regjistruar në shkollat e arsimit bazë, dhe atij të mesëm (sipas shkollës, sipas ciklit arsimor, vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel))<br>Edukator për femije kopshti ; Numri mesatar i fëmijëve për kopësht (Raporti numrit të fëmijëve kundrejt numrit total të kopshteve);<br>Numri mesatar i fëmijëve në një klasë (Raporti numrit total të fëmijëve kundrejt numrit total të grupeve në arsimin parashkollor) |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Nxënës në klasë: Numri mesatar i nxënësve në një klasë (Raporti numrit total të nxënësve kundrejt numrit total të klasave në arsimin bazë;<br>Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të nxenesve te arsimit bazë dhe parashkollor (mijë leke/nxenes)<br>Numri i shkollave që i shërbejnë fëmijëve me aftësi të veçanta |
| **Zbatimi i planit të mirëmbajtjes dhe reagimit të shpejtë në raste emergjente, me qëllim ruajtjen e funksionalitetit, sigurisë dhe integritetit të ambienteve arsimore në të gjitha nivelet.** | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet; | Shkollat, kopshtet | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike Perfshire ne zerin "Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime" | Nr. ndërhyrjeve të realizuara në godina (Lyerje, ndarje ambientesh, mirëmbajtje kaldajash, elektroshtepiakesh, kompjuterash, printerash, pajisjesh të zyrave) |
| **Kryerja e shërbimeve higjeno sanitare të përditshme dhe** aplikimi i masave përmirësuese për të garantuar **kushte të pastra, të sigurta dhe të shëndetshme për fëmijët, nxënësit dhe stafin pedagogjik në shkolla dhe kopshte.** | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike | Shkollat, operatorë të higjienës, kopshtet | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin "*Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime*" | Nr. i shkollave me kushte të përmirësuara higjieno-sanitare<br>Nr. i kopshteve me kushte të përmirësuara higjieno-sanitare |
| **Instalimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i sistemeve të ngrohjes për të siguruar mjedise komode dhe të përshtatshme gjatë gjithë** sezonit të ftohtë në **institucionet e arsimit parashkollor, bazë dhe të mesëm.** | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike | Operator ë të energjisë, | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin "*Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime*" | Nr. i institucioneve arsimore parashkollre, te arsimit bazë dhe atij të mesëm me sistem funksional ngrohjeje<br>Numri i shkollave qëngrohen me dru zjarri<br>Numri i shkollave që ngrohen me kaldaja dhe naftë dhe gaz |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Furnizimi i rregullt i institucioneve arsimore me mjete administrative dhe logjistike të nevojshme për funksionimin e përditshëm dhe realizimin efektiv të procesit mësimor.** | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin | Shkollat | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin "*Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime*" | Nr. i institucioneve të arsimit parauniversitar të furnizuara me kancelari (sipas llojit, ciklit të arsimit) |
| **Sigurimi i kushteve për mbrojtje nga zjarri** | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin<br>Zyra e Emergjencave | Zjarrfikë sja, NjA | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin "*Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime*"*l* | Nr. i fikseve të vendosura dhe funksionale në institucionet arsimore parauniversitare;<br>Nr. i institucioneve arsimore parauniversitare (sipas llojit, ciklit arsimor) në kushte të sigurta përsa i përket pajisjes me fikse zjarri;<br>Numri i shkollave me shërbim sigurie; |
| **Furnizimi me dokumentacion zyrtar për institucionet arsimore**<br>- Prokurimi dhe shpërndarja e formularëve, regjistrave dhe dokumenteve të tjera të nevojshme për administrimin dhe arkivimin institucional të shkollave dhe kopshteve. | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin | Shkollat | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin "*Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbim*" | Nr. i shkollave/kopshteve të pajisura me dokumentacion |
| **- Mbështetja e procesit mësimor përmes pajisjes së kopshteve me mjete didaktike që përmirësojnë përvojën e të nxënit dhe zhvillojnë kompetencat e fëmijëve.** | **2026–2028** | **Sektori I Arsimit dhe Kulturës** | **Kopshtet MAS** | **Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin "*Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime*"**<br>**Donacione, prindërit** | **Nr. i institucioneve të arsimit parashkollor të pajisura me mjete didaktike** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Sigurimi i ushqimit për fëmijët **në institucionet parashkollore** | 2026-2028 | Zyra Shëndetit Publik & Arsimi | Operatorët e licencuar, Ministria e Arsimit, Sportit (MAS) | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin "*Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime*" | Numri i kopshteve me dreke |
| **Dezinfektimi i institucioneve arsimore** në përputhje me protokollet higjieno-sanitare për të mbrojtur shëndetin e fëmijëve dhe stafit. | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin Njësia përgjegjëse për shërbimet publike | Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), operatorë të kontraktuar | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin "*Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime*"+ fond emergjence | Nr. i dezinfektimeve të kryera në vit në secilin institucion arsimor parauniversitar; |
| Sigurimi i logjistikës së transportit për institucionet arsimore **Vënia në dispozicion e mjeteve të transportit dhe mbështetja teknike për nevojat operacionale dhe administrative të institucioneve arsimore që administrohen nga bashkia.** | Çdo vit | ZVA | Drejtoria e Transporteve, administrata | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin sherbim transporti ne "*Shpenzime Korrente, Mallra dhe sherbime*" | Shpenzime për karburant, siguracione, pjesë këmbimi për automjete të shërbimit të DA, dhe mbështetje për administratën |

| Objektivi OT 2 Realizimi i ndërhyrjeve në infrastrukturën arsimore (rikonstruksion, riparime, sistemet e ngrohjes), pajisja me mjete bashkëkohore, si dhe përmirësimi i mjediseve të mësimdhënies dhe menaxhimit shkollor. | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitete** | **Periudha e zbatimit** | **Përgjegjës** | **Partnerë** | **Burimet financiare** | **Tregues** |
| **Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit bazë:** | | | | | |
| 1. **Rikonstruksion shkolla 9 – vjeçare "Irfan Hajrullaj"** | 2025-2026 | Njësia përgjegjesë për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet | Bashkia | Buxhet vendor transfertë e pakushtëzuar specifike + bashkefinancim qeveria qedrore | Nr. i institucioneve të arsimit bazë të rikonstruktuara;<br><br>Përmirësim i kushteve |
| 2. **Rikonstruksion shkolla 9 – vjeçare "Demir Gashi"** | 2027 | Njësia përgjegjesë për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet | Bashkia | Financim i huaj | Nr. i institucioneve të arsimit bazë të rikonstruktuara;<br><br>Përmirësim i kushteve |
| 3. **Rikonstruksion i shkollës 9 – vjeçare të fshatit Sllove** | 2025-2027 | Njësia përgjegjesë për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet | Bashkia | Financim i brendshëm | Nr. i institucioneve të arsimit bazë të rikonstruktuara;<br><br>Përmirësim i kushteve |
| 4. **Ripatime në godinat arsimore Bashkia Dibër** | 2025-2027 | Njësia përgjegjesë për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet | Bashkia | Financim i brendshëm | Nr. i institucioneve arsimore të riparuara;<br><br>Përmirësim i kushteve |
| 5. **Rikonstruksion i kopshtit Maqellare** | 2025-2027 | Njësia përgjegjesë për arsimin, | Bashkia | Financim i brendshëm | Nr. i institucioneve arsimore parashkollore të rikonstruktuara; |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet | | | Përmirësim i kushteve |
| 6. | **Rikonstruksion i kopshtit të lagjes Kamen** | 2025-2027 | Njësia përgjegjesë për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet | Bashkia | Financim i brendshëm | Nr. i institucioneve arsimore parashkollore të rikonstruktuara;<br><br>Përmirësim i kushteve |
| 7. | **Blrje dhe vendosje dyer dritare për objektet arsimore dhe social kulturore** | 2025-2027 | Njësia përgjegjesë për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet | Bashkia | Financim i brendshëm | Nr. i institucioneve arsimore parashkollore të rikonstruktuara;<br><br>Përmirësim i kushteve |
| 8. | **Blerje paisje për koshtet, konviktin dhe çerdhet e qytetit** | 2025 - 2026 | Njësia përgjegjesë për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet | Bashkia | Financim i brendshëm | Nr. i institucioneve arsimore parashkollore të rikonstruktuara;<br><br>Përmirësim i kushteve |
| 9. | **Hartim dhe zbatim i një Projekt i ri investimi ne fushën e Arsimit** | 2026 - 2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet | Bashkia | Financim i brendshëm | Nr. i institucioneve arsimore parashkollore të rikonstruktuara;<br><br>Përmirësim i kushteve |

Qëllimi 2 (Q2) – Përmirësimi i cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në arsimin parashkollor dhe atë bazë, me fokus në zhvillimin profesional të stafit dhe përkrahjen e fëmijëve me nevoja të veçanta.

| Objektivi 2.1 – Zgjerimi i shërbimeve mbështetëse si mësues ndihmës, psikologë dhe punonjës socialë, për të mundësuar edukim të barabartë për çdo fëmijë, veçanërisht ata me aftësi ndryshe | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitete** | **Periudha e zbatimit** | **Përgjegjës** | **Partnerë** | **Burimet financiare** | **Tregues** |
| **Unifikimi dhe pajisja me materiale didaktike dhe trajnime për edukatorët dhe fëmijët në kopshte;** | Çdo vit | Sektori I Arsimit dhe Kulturës | MAS, partnerë zhvillimi | Buxhet vendor + transfertën e pakushtëzuar specifike përfshirë në zërin "*Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli*" dhe "*Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore*" Organizara partnere të tjera | Nr. i fëmijëve (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) që përfitojnë nga mjetet dhe trajnimet |
| **Rritja e kapaciteteve të stafit arsimor të institucioneve parashkollore, në funksion të garantimit të një edukimi cilësor dhe mbështetës për zhvillimin e hershëm të fëmijëve.** | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin, | MASR, institucionet arsimore, OSHC, ASKAP | Buxhet vendor + transfertën e pakushtëzuar specifike përfshirë në zërin "*Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli*" dhe "*Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore*" | Nr. (përqindja) i edukatorëve të trajnuara; Nr. i trajnimeve të realizuara; Nr. i tematikave të përzgjedhura nga vetë stafi i edukatoreve; përmirësimi i praktikave të mësimdhënies; |
| **Përmirësimi dhe trajnimi i kapacitetve të stafit mbështetës** në institucione e arsimit | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin, | MASR, institucionet arsimore, | Buxhet vendor + transfertën e pakushtëzuar | Nr. (përqindja) i personelit të shërbimeve mbështetës të trajnuar; |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **parauniversitar (kopshte dhe shkolla) në funksion të përmirësimit të shërbimit.** | | | OSHC, ASKAP | specifike përfshirë në zërin "*Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli*" dhe "*Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore*" | Nr. i trajnimeve të realizuara; |

[illegible]

| Aktivitete | Periudha e zbatimit | Përgjegjës | Partnerë | Burimet financiare | Tregues |
|---|---|---|---|---|---|
| **Angazhimi i mësuesve ndihmës në kopshte** | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin.<br>Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore | OJQ sociale, MAS | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike përfshirë në zërin "*Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli*" dhe "*Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore*" | Nr. (përqindja) i fëmijëve (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) me ndihmë sociale;<br>Nr./(përqindja) i fëmijëve përfitues të mështetjes me mësues ndihmës; |
| **Institucionalizimi dhe funksionalizimi i strukturave menaxhuese pjesëmarrëse dhe këshilluese në institucionet arsimore, përfshirë**<br>• **Bordin e institucionit,**<br>• **Këshillin e Prindërve dhe**<br>• **Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në kopshte dhe shkolla.** | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin | Administratorët e Njësive Administrative; këshilli bashkiak; Kopshtet; Prindërit | Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor) | Struktura menaxhuese në kopshte dhe shkolla aktive<br><br>Pjesëmarrja e balancuar gjinore e prindërve (nënë/baba) në strukturat menaxhuese të kopshteve dhe shkollave |
| **Ofrimi i shërbimit psiko-social në kopshte** | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin, | Kopshtet; OSHC | Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor) | Nr. i fëmijëve (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore; Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale | | | mbështetur me shërbim psiko social |
| **Mbështetja e fëmijëve nga familjet në nevojë** | 2026–2028 | | Njësia përgjegjesë për arsimin; Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale | Shkollat, Njësitë Administrative, OJQ | Buxhet vendor + donacione + projekte sociale | Nr. i nxënësve (vajza/djem) nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel të mbështetur |

[illegible] ... dhe aktiviteteve sensibilizuese për rritjen e pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe në jetën institucionale

| Aktivitete | Periudha e zbatimit | Përgjegjës | Partnerë | Burimet financiare | Tregues |
|---|---|---|---|---|---|
| Organizimi i fushatave informuese dhe edukative për prindërit dhe kujdestarët, veçanërisht në lagje dhe fshatra me mungesë informacioni mbi rëndësinë e edukimit të hershëm. | Tremujori I–II 2026, 2027, 2028 | Drejtoria e Arsimit në Bashki | Drejtoria e Shëndetësisë, OJF lokale, Këshillat e Prindërve | Zëri 602 – Mallra dhe shërbime; Donatorë lokalë OSHC | - Numri i fushatave të realizuara<br>- Numri i prindërve të informuar<br>- Rritje e regjistrimeve në kopsht në zonat target |
| Zhvillimi i bashkëpunimit me punonjësit socialë dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijës për të identifikuar fëmijët që nuk ndjekin kopshtin për shkak të kushteve ekonomike, kulturore ose sociale, dhe për të ofruar mbështetje të përshtatur.këshilluese në institucionet arsimore | Tremujori II–III 2026, 2027, 2028 | Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës, Drejtoria e Arsimit | Qendrat Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, OJF | Zëri 602 dhe 606 – Trajnime dhe koordinim; Projekte të mbështetura | - Numri i fëmijëve të identifikuar<br>- Numri i fëmijëve të përfshirë në shërbim pas ndërhyrjes<br>- Raste të trajtuara përmes planit të mbështetjes |
| Nxitja e përfshirjes së këshillave të prindërve dhe organizatave **komunitare lokale në proceset** vendimmarrëse, planifikuese dhe **monitoruese të shërbimit arsimor.** | Tremujori I–IV 2026, 2027, 2028 (proces i **vazhdueshëm)** | Drejtoria e Arsimit dhe **Institucionet** Arsimore | Bordi i Shkollës, Bordi **i kopshtit,** Këshillat e **Prindërve, Komuniteti lokal** | Zëri 600 dhe 606 – Orë **pune,** mbledhje dhe **aktivitete komunitare** | - Numri i këshillave funksionale<br>- Frekuentimi i takimeve<br>**- Propozime të komunitetit të** reflektuara në vendimmarrje |

Qëllimi 3 (Q3)- Nxitja e zhvillimit kulturor, social dhe emocional të fëmijëve nëpërmjet aktiviteteve jashtë kurrikulës dhe përfshirjes komunitare.

Objektivi O3.4: Organizimi i veprimtarive kulturore, sportive dhe artistike në institucionet arsimore, në partneritet me institucionet e tjera lokale, organizata rinore, artistike dhe sportive për të nxitur talentet dhe zhvillimin e integrimin e gjithanshëm të fëmijëve.

| Aktivitete | Periudha e zbatimit | Përgjegjës | Partnerë | Burimet financiare | Tregues |
|---|---|---|---|---|---|
| Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive, lojëra edukative dhe mbështetje emocionale në institucionet e Arsimit: | Çdo vit sipas kalendarit të aktiviteteve të miratuara në planin e institucioneve arsimore | Shkollat/kopshtet | Prindër, OJQ, MAS | Buxhet vendor, mbështetje donatorësh | Numër dhe larmi aktivitetesh; përfshirje gjithëpërfshirëse; |
| 1. 23–30 Shtator – Java Evropiane e Sportit<br>⚘ Loja sportive në oborrin e kopshtit (loja popullore)<br>⚘ Ushtrime në natyrë (gimnastikë)<br>⚘ Loja të ndryshme lëvizore, Gara me biçikleta, etj.) | | | | | |
| 2. Prill–Maj – Java Olimpike<br>⚘ Loja të ndryshme sportive (stafeta me flamuj, topa)<br>⚘ Gara vrapimi, midis kopshteve në grupe<br>⚘ Gara me biçikleta | | | | | |
| **3.** 20 Nëntor – Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve<br>⚘ Bisedë, postera, aktivitete në natyrë (Kam të drejë të luaj)<br>⚘ Ekspozitë me materiale të përgatitura nga fëmijët "Të drejtat e mia"<br>⚘ "Unë mbroj të drejtat e mia" (bisedë) | | | | | |
| **4.** Dita e Luftës Kundër Bullizmit (21 nëntor)<br>⚘ Bisedë me fëmijët | | | | | |
| 1. Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe<br>⚘ Postera me gjuhën shqipe & ilustrime | | | | | |

- Koncert për gjuhën shqipe (Gjuha jonë sa e mirë)

2. Dita Ndërkombëtare e Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (3 dhjetor)
   - Biseda sensibilizuese për fëmijët me nevoja të veçanta
   - Loja me role (si t'i ndihmojmë shokët me nevoja të veçanta)
   - Ekspozitë me punime të përgatitura nga fëmijët me AK

3. Dita Botërore e Gjuhës Amtare
   - Vizitë në bibliotekë
4. Dita Botërore e Ujit (UNESCO 22 mars)
   - Rëndësia dhe vlerat e ujit (bisedë, prezantime)
   - "Uji është jetë" (Postera, eksperiment me ujëra)
   - Bisedë për vlerat e ujit

5. Dita Ndërkombëtare e Romëve
   - Bisedë për fëmijët romë

6. Zakonet dhe traditat e romëve

7. Dita Botërore e Librit (23 prill)
   - Ne dimë të bëjmë libra (aktivitet krijues)
   - Vizitë në bibliotekë
   - Dhuro një libër, hap një dritare (fushatë sensibilizuese)

8. Dita Botërore e Mjedisit (5 qershor)
   - Ekspozitë me mjete të riciklueshme
   - Mbrojmë tokën, planetin tonë (projekt)
   - Mbjellim lule në oborrin e kopshtit ose në vazo (aktivitet praktik)
   - Mbajmë pastër mjedisinku mësojmë e luajmë (aktivitet praktik, bisedë)
   - Ekskursion në lulishten e qytetit

9. Yjet e Vallzimit
   - Konkurs midis kopshteve të qytetit

## 10. Plani i investimeve kapitale

Lista e projekteve të investimeve për periudhën afatmesme 2026 -2028 (në mijë lekë) përfshin projektet do të financohen nga Buxheti i bashkisë Dibër

Buxheti që mbështet planin për zhvillimin e arsimit parauniversitar për periudhën 2026–2028 arrin në: 14.300 mijë lekë për vitin 2026, 15.400 mijë lekë për vitin 2027, dhe 15500 mijë lekë për vitin 2028, të detajuara sipas listës më poshtë:

*në mijë lekë*

| KODI | EMËRTIMI I PROJEKTIT/PRODUKTIT | BURIMI I FINANCIMIT | DATA E FILLIMIT | DATA E PËRFUNDIMIT | KOSTO TOTALE | 2023 FAKTI | 2024 FAKTI | 2025 BUXHETI | 2026 PLANI | 2027 PLANI | 2028 PLANI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet Kapitale sipas Projekteve | | | | | | | | | | | |
| 18BC895 | Bashkefinancim per objektin "Rikonstruksion Shkolla 9- vjeçare "Irfan Hajrullaj", Peshkopi (18BC895) | Financim i Brendshëm | 31/01/2025 | 31/12/2025 | 10,902 | 500 | 8,402 | 2,000 | 0 | 0 | 0 |
| 22AC526 | Rikonstruksion Shkolla 9- vjecare " Demir Gashi " (22AC526) | Financim i Huaj | 31/05/2027 | 31/12/2027 | 142,063 | 0 | 136,063 | 0 | 0 | 6,000 | 0 |
| P912-DI-002 | Rikonstruksion shtese anesore te Kopshtit Magellare (1060440) | Financim i Brendshëm | 01/01/2025 | 31/12/2027 | 6,000 | 0 | 0 | 2,400 | 2,400 | 1,200 | 0 |
| P912-DI-003 | Rikonstruksion i kopshtit te lagjes Kamen (1060441) | Financim i Brendshëm | 01/01/2025 | 31/12/2027 | 10,000 | 0 | 0 | 4,000 | 4,000 | 2,000 | 0 |
| P912-DI-004 | Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare te fshatit Sllove (1060443) | Financim i Brendshëm | 01/01/2025 | 31/12/2027 | 5,000 | 0 | 0 | 2,000 | 2,000 | 1,000 | 0 |
| P912-DI-005 | Riparime ne godinat arsimore Bashkia Diber (1060444) | Financim i Brendshëm | 01/01/2025 | 31/12/2027 | 5,000 | 0 | 0 | 2,000 | 2,000 | 1,000 | 0 |
| P912-DI-006 | Blerje dhe vendosje dyer dritare per objektet arsmiore dhe social kulturore (1060453) | Financim i Brendshëm | 01/01/2025 | 31/12/2025 | 2,500 | 0 | 0 | 2,500 | 0 | 0 | 0 |
| P912-DI-007 | Mbikqyrje kolaudime | Financim i Brendshëm | 01/05/2025 | 31/05/2025 | 161 | 0 | 0 | 161 | 0 | 0 | 0 |
| P912-DI-008 | Blerje paisje per kopshte , konvikt dhe cerdhet e qytetit (1060368) | Financim i Brendshëm | 01/05/2025 | 31/05/2025 | 2,000 | 0 | 0 | 2,000 | 0 | 0 | 0 |
| P912-DI-009 | Projekt i ri | Financim i Brendshëm | 31/01/2025 | 31/05/2028 | 36,600 | 0 | 13,000 | 0 | 3,900 | 4,200 | 15,500 |
| | Totali i Shpenzimeve Kapitale sipas Projekteve | | | | 220,226 | 500 | 157,465 | 17,061 | 14,300 | 15,400 | 15,500 |

## 11. Monitorimi dhe vlerësimi

Zbatimi efektiv i Planit të Arsimit Parauniversitar kërkon një sistem të qartë dhe të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, që siguron ndjekjen sistematike të progresit dhe ofron bazën për përmirësime të vazhdueshme. Ky sistem është i lidhur ngushtë me objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit dhe mbështetet në të dhëna të verifikueshme, pjesëmarrje të aktorëve dhe transparencë institucionale.

### Indikatorët e Performancës

Indikatorët e performancës janë të përqendruar në vlerësimin e rezultateve të arritura në raport me objektivat strategjikë. Ata janë të ndërlidhur me çdo kategori aktivitetesh në planin e veprimit dhe do të përdoren për matjen e progresit të përvitshëm. Këta përfshijnë:

- Numrin e institucioneve të rikonstruktuara ose me kushte të përmirësuara;
- Numrin i kopshteve (hapësirave) të reja funksionale;
- Rritjen e regjistrimeve në kopshte dhe përfshirjen e fëmijëve nga grupe në nevojë;
- Numrin e mësuesve dhe edukatorëve të trajnuar;
- Cilësinë e mësimdhënies dhe përdorimin e mjeteve didaktike dhe teknologjisë;
- Numrin e aktiviteteve jashtëmësimore dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në to;
- Mbështetjen sociale për fëmijët në nevojë (ushqim, mjete, shërbime psiko-sociale);
- Eficienca në furnizim, mirëmbajtje dhe shërbime mbështetëse.

### Planifikimi i vlerësimit të progresit

Progresi i planit do të vlerësohet përmes mekanizmave të strukturuar të raportimit dhe analizës, të cilët do të jenë të integruar në ciklin e planifikimit buxhetor dhe vendimmarrjes vendore. Vlerësimi do të përfshijë:

- Raportime vjetore mbi realizimin e aktiviteteve të planifikuara;
- Matjen e ndikimit të investimeve në infrastrukturë dhe cilësi shërbimi;
- Analizën e të dhënave të mbledhura përmes monitorimit në terren;
- Vlerësimin e përmirësimit të qasjes, përfshirjes dhe mjedisit të të nxënit;
- Ndërlidhjen e progresit me planifikimin e ardhshëm afatmesëm.

### Përfshirja e aktorëve të jashtëm

Për të garantuar objektivitetin, transparencën dhe përmirësimin e vazhdueshëm, do të sigurohet përfshirja aktive e aktorëve të jashtëm, si:

- Ekspertë të pavarur në fushën e arsimit, të ftuar për të kryer vlerësime tematike;
- Organizata joqeveritare që merren me cilësinë e arsimit dhe përfshirjen sociale;
- Këshillat e prindërve, drejtuesit e shkollave dhe komunitetet vendore;
- Njësitë e statistikës/performabces dhe monitorimit të bashkisë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave;
- Partnerë ndërkombëtarë në kuadër të projekteve të mbështetura financiarisht.

Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimi

Monitorimi i planit do të realizohet në dy drejtime kryesore:

- **Monitorimi i nivelit të realizimit të aktiviteteve të planifikuara**
- **Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve në komunitetin arsimor**

Monitorimi i realizimit të aktiviteteve

Çdo aktivitet i planit do të vlerësohet në bazë të një sistemi pikëzimi nga 0 deri në 10, ku:
0 – Aktiviteti nuk ka nisur.
1–9 – Aktiviteti është pjesërisht i realizuar, në varësi të nivelit të zbatimit.
10 – Aktiviteti është realizuar plotësisht sipas planifikimit.

Për secilin objektiv strategjik të planit, do të përcaktohet numri total i pikëve maksimale, duke shumëzuar numrin e aktiviteteve të planifikuara për objektivin përkatës me 10 (p.sh., 5 aktivitete × 10 = 50 pikë maksimale për objektivin).

Gjatë zbatimit, pikët reale të arritura për çdo aktivitet do të regjistrohen, dhe më pas do të përmbildhen në nivel objektivi. Kjo do të mundësojë llogaritjen e përqindjes së realizimit të secilit objektiv në kohë reale:

*Perqindja e realizimit te objektivit= (Pike te realizuara/Piket maksimale)×100*

Ky mekanizëm do të sigurojë një vlerësim të qartë, të matshëm dhe të krahasueshëm për zbatimin e planit përgjatë viteve.

Vlerësimi i ndikimit në komunitet

Për të matur ndikimin e aktiviteteve në komunitet, do të monitorohet shkalla e pjesëmarrjes së institucioneve arsimore dhe fëmijëve në zbatimin e tyre.

Për çdo aktivitet do të vendosen targete të matshme:

- Numri i kopshteve dhe shkollave të synuara.
- Numri i fëmijëve të parashikuar për përfshirje (në kopsht dhe shkollë, sipas rastit).

Në përfundim të zbatimit të çdo aktiviteti, do të regjistrohet:

- Numri real i institucioneve që morën pjesë (në kopsht ose shkollë).
- Numri real i fëmijëve të përfshirë.

Në rastet kur aktiviteti synon vetëm një kategori (p.sh. vetëm kopshtet), pjesëmarrja për kategorinë tjetër do të konsiderohet.

Për çdo aktivitet do të llogaritet përqindja e pjesëmarrjes së arritur sipas formulës:

*Perqindja e pjesemarrjes=(Numri real i pjesemarresve/Numri target)×100*

Ky tregues do të ndihmojë në vlerësimin e shkallës së përfshirjes dhe impaktit që ka pasur secili aktivitet në komunitetin arsimor.

## 12. Rishikimi dhe përshtatja e planit

Rishikimi dhe përshtatja e planit janë mekanizma thelbësorë për të siguruar vazhdimësinë, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të planifikuara në fushën e arsimit parauniversitar në Bashkinë Dibër. Këto procese shërbejnë për të ruajtur koherencën midis objektivave të planit, nevojave reale në terren dhe zhvillimeve të reja institucionale, ligjore apo sociale.

Procesi i rishikimit

Rishikimi i planit do të bëhet në mënyrë të strukturuar dhe të paracaktuar, me qëllim që të vlerësohet në mënyrë periodike efektiviteti i masave dhe aktiviteteve të ndërmarra. Planifikohen këto forma rishikimi:

**Rishikimi** vjetor – i fokusuar në përditësimin e planit të veprimit dhe buxhetit vjetor në funksion të rezultateve dhe ndryshimeve të kontekstit;

**Rishikimi afatmesëm** (në fund të vitit 2027) – për të analizuar realizimin e objektivave strategjike, performancën e indikatorëve dhe për të orientuar masat për vitin 2028;
**Rishikime të jashtëzakonshme**, në rast të ndryshimeve madhore (si reformë e kuadrit ligjor, emergjenca, ndryshime buxhetore të rëndësishme).
Ky proces do të kryhet në mënyrë të ndërsektoriale, me pjesëmarrjen e drejtorive përgjegjëse, përfaqësuesve të institucioneve arsimore dhe aktorëve të tjerë vendorë.

**Përshtatja e masave dhe aktiviteteve**
Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga monitorimi dhe vlerësimi i planit, si dhe në konsultimet me komunitetin arsimor, do të ndërmerren përshtatje të nevojshme në:
**Aktivitete konkrete** – duke përmirësuar përmbajtjen, kohëzgjatjen, mënyrën e zbatimit apo përgjegjësit;
**Alokimin e burimeve** – në rast se disa fusha kërkojnë më shumë mbështetje për të arritur objektivat;
**Prioritetet vjetore** – në përputhje me nevojat emergjente të fëmijëve, stafit arsimor apo komunitetit lokal;
**Metodologjinë e zbatimit** – duke integruar praktikat më të mira dhe rekomandimet e vlerësimeve të jashtme.
Ky fleksibilitet në përshtatje synon të sigurojë që plani të mos mbetet një dokument statik, por të jetë një instrument dinamik, funksional dhe i orientuar drejt rezultateve reale për përmirësimin e arsimit parauniversitar në Bashkinë Dibër.

## 13. Raportimi dhe transparenca

Zbatimi i Planit të Arsimit Parauniversitar do të shoqërohet me mekanizma të qartë raportimi dhe transparence, për të garantuar përgjegjshmëri institucionale dhe përfshirje qytetare në vlerësimin e progresit.

- **Raportimi i progresit** do të realizohet përmes raporteve periodike vjetore, të cilat do të përfshijnë ecurinë e zbatimit të objektivave, sfidat e hasura dhe masat korrigjuese të ndërmarra nga njësitë përkatëse.
- **Përfshirja e publikut** do të sigurohet përmes publikimit të raporteve dhe rezultateve në faqen zyrtare të bashkisë, organizimit të takimeve konsultative me komunitetin dhe mundësimit të pjesëmarrjes qytetare në propozimin dhe vlerësimin e masave për përmirësimin e sistemit arsimor.

## 14. Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar

**Kuadri Kushtetues dhe Ligjor i përgjithshëm**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 57, pika 1
- Ligji Nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2018
- Ligji Nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen 0Vendore"
- Ligji Nr. 9936/2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji Nr. 68/2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"
- Ligji Nr. 9632/2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar

**Arsimi Parashkollor dhe i detyrueshëm (Bazë)**

- Urdhër nr. 31, datë 28.01.2020, "Për miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare"
- Udhëzim Nr. 14, datë 10.7.2023, "Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore në arsimin parauniversitar"
- Udhëzim i përbashkët MAS–MEKI nr. 13, datë 10.07.2024, "Për vitin shkollor 2024–2025 në sistemin arsimor parauniversitar"
- Udhëzim Nr. 25, datë 25.07.2018, "Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor"
- Urdhër nr. 199, datë 07.05.2024, "Për miratimin e Kornizës së vlerësimit të cilësisë së kopshtit"

**Përfshirja dhe mbrojtja e fëmijëve**

- Ligji Nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji Nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"
- Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025
- Udhëzim Nr. 21, datë 08.08.2014, "Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë"
- Udhëzim i përbashkët MAS–MShMS nr. 658, datë 23.09.2019, "Për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në internet"

**Shërbimi psiko-Social dhe ërfshirja Sociale**

- Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020, "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar"
- Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor, për punonjësit e ZVA-ve dhe strukturat arsimore vendore

